



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2384 prot

Durrës, më 29.12 2023

VENDIM

Nr 86, datë 29.11.2023

PËR

**“KRIJIMIN DHE INTEGRIMIN E NJËSISË SË AKSESUESHMËRISË NË
STRUKTURËN E ZYRËS SË KARRIERËS DHE ALUMNIT TË UNIVERSITETIT
“ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS”**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, në VKM nr. 1503 datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”, në VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuar”, në Statutin DHE Kodin e Etikës së Universitetit “Aleksandër Moisiu”, mbështetur nga projekti IDEA (Arsimi terciar Gjithëpërfshirës në Ballkanin Perëndimor), Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Të krijojë Njësinë e Aksesueshmërisë në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, e cila do funksionojë si nën-njësi pranë Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, në Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimit Akademik.
2. Kjo Njësi do të ketë funksionet si më poshtë:
 - Të ofrojë akses maksimal në të gjitha programet e studimit në Universitetin “Aleksandër Moisiu” për personat me shikim dhe dëgjim të dëmtuar, personat me lëvizshmëri të kufizuar ose persona me lloje të tjera të aftësisë së kufizuar.

- Të informojë dhe udhëzojë studentët e ardhshëm dhe të regjistruar mbi kërkesat e aksesit, bursat e disponueshme dhe teknologjitë ndihmëse.
- Të lehtësojë mbështetjen metodologjike për stafin akademik dhe administrativ.
- Të sigurojë të dhëna, raporte dhe rekomandime për të çuar përpara objektivat e përfshirjes institucionale.
- Të mbështesë ngjarje, projekte dhe aktivitete të fokusuara në gjithëpërfshirje.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- √ Zv. Rektorët
- √ Administratori
- √ Drejtuesit e njësive kryesore
- √ Drejtorja e Administrimit dhe Shërbimit Akademik

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
Prof. Dr. Ksanela SOTIROFSKI

